



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Drejtoria e Arsimit
Nr. 04/120
Më: 16/04/2024

Duke u bazuar në UA nr.02/2016 Për Aktivitetet Jashtëshkollore i dt.12/01/2016, ofertën me numër protokollit 01/379 i dt.02/04/2024 lidhur me organizimin e ekskursionit për maturantë në SHMLE “Kadri Kusari” në Gjakovë, për bartjen e nxënësve në Republikën e Shqipërisë me qëndrim në Durrës. Nga Durrësi vizitohen: Vlora, Tirana dhe Kruja. Ekskursioni zgjat 3 bujtje (gjithsej tri bujtje gjegjësisht katër ditë, pasion i plotë) prej datës 13/05/2024 deri më 16/05/2024. Lista e konkurrentëve për të fituar ofertën për ekskursion të maturantëve të Shkollës “Kadri Kusari” në Gjakovë:

1. SH.P.K. “METI -Tours ” me çmim 120 €
2. SH.P.K. “METI COMERC ” me çmim 121 €
3. N.P.T. “Kushtrimi NMI” me çmim 89 €

Raport i Komisionit selektues:

Hapja e ofertave u bë me dt.12/04/2024 në ora 14:00 sipas ofertës nr.01/379 i dt.02/04/2024 ku prezent kanë qenë përfaqësuesit e Drejtorisë së Arsimit : znj. Flutur Këpuska, z. Anton Pnishi Kryetari i Këshillit Drejtues të Shkollës “Kadri Kusari” në Gjakovë, dhe znj. Merita Bokshi Drejtoresha e Shkollës “Kadri Kusari” në Gjakovë.

Të gjitha ofertat janë hapur dhe lexuar në praninë e kompanive konkurruese.

Firma transportuese SH.P.K. “METI TOURS” ka konkuruar me çmim prej 120.00€, për nxënës ku iu është ofruar qëndrim në hotelin “Bonita” Tiranë, Kavajë, Golem (pranë karburantit). Në ofertë përfshihen tri (3) bujtje me pasion të plotë që nga dt.13/05/2024 gjer me dt.16/05/2024. SHPK ”Meti-Tours” në ofertë përfshin që mësimdhënësit (kujdestarët e klasave) do të jenë pagesë, dhe poashtu ka cekë që kompania në fjalë e merr përsipër bartjen e nxënësve në mbrëmjen e maturës. Vizitat në qytetet të Republikës së Shqipërisë bëhen me marrëveshje në mes të palëve kontraktuese.

Kompania SHPK”Meti Tours” posedon Licencën D – për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të udhëtarëve me autobus brenda dhe jashtë Kosovës, licencë kjo e vlefshme nga dt.07/06/2019 gjer me dt.06/06/2024, Çertifikatën e Regjistrimit(ARBK) të SH.P.K “Meti Tours”, posedon Çertifikatën e Mjekut dr.Baton Lleshi ku është lidhur marrëveshja mes tij dhe drejtorit Hysen Musa që përfaqëson firmën transportuese “Meti – Tours” për përkujdesjen e nxënësve (maturantëve) të shkollës “Kadri Kusari” në Gjakovë. Janë të përfshirë 3 shoferë e të pajisur me çertifikatën mjekësore dhe janë prezantuar 3 autobusë. Ka prezentuar Konfirmim Rezervimi nga Kompleksi “Bonita” të vërtetuar nga pronari Astrit Ismaili së bashku me Licencën e Agjensionit të Akreditimeve të Ushqimeve -Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL)-Republika e Shqipërisë për akomodimin e nxënësve të SHMLE “Kadri Kusari”.

Firma transportuese SH.P.K. "METI COMERC" ka konkuruar me çmim prej 121€ për nxënës. Oferta bazohet në 3 (tri) bujtje me pasion të plotë, ku ju është ofruar qëndrim në Hotel "DIAMMA RESORT" ndërsa vizita qyteteve të Republikës së Shqipërisë bëhen me marrëveshje në mes të palëve kontraktuese. Janë të përfshirë katër (4) shoferë e të pajisur me certifikatë mjekësore dhe janë prezantuar 4 autobusë. Posedon Licencën D – për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të udhëtarëve me autobus brenda dhe jashtë Kosovës, licencë kjo e vlefshme nga dt.08/03/2021 gjer me dt.07/03/2026, gjithashtu ka prezantuar Çertifikatën e Regjistrimit, dhe Vërtetimin Tatimor, Licencën e Punës Dr.Ali Sadiku së bashku me kontratën e punës të kontraktuar nga SH.P.K. Meti-Comerc" për kryerjen e shërbimeve mjekësore për nxënësit (maturantët).Firma ofron 10 persona gratis.

SH.P.K."Meti Comerc" ka munges të dokumentacionit lidhur me konfirmim rezervimi nga Hotel "DIAMMA RESORT" të bazuara sipas kriterëve të Ofertës së shkollës nr.01/379 i dt.02/04/2024.

Firma transportuese N.P.T. "Kushtrimi NMI" ka konkuruar me çmim prej 89.00€, për nxënës gjithashtu ka ofruar nga 2 nxënës pa pagesë dhe kujdestarët e klasës. Vizitat në qytetet të Republikës së Shqipërisë bëhen me marrëveshje në mes të palëve kontraktuese.

Sipas ofertës së prezantuar iu është ofruar qëndrimi në Hotel "Dolce Vita " Shkambi i Kavajës në Durrës, ku edhe ka prezantuar në kopje konfirmim rezervimi e hotelit nga administratori Ymer Lushakaj. Në ofertë përfshihen tri (3) bujtje me pasion të plotë që nga dt.13/04/2024 gjer më dt.16/04/2024.

N.P.T."Kushtrimi NMI" posedon Licencën D – për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të udhëtarëve me autobus brenda dhe jashtë Kosovës, licencë kjo e vlefshme nga dt.15/04/2021 gjerë më dt.14/04/2026, Çertifikatën e regjistrimit ARBK, posedon Çertifikatën e Mjekut dr.Xhevat Musaj mirëpo i mungon kontrata në mes mjekut me firmës transportuese për përkuqdesjen e nxënësve (maturantëve) të shkollës "Kadri Kusari" në Gjakovë. Janë të përfshirë 5 shoferë të pajisur me çertifikatën mjekësore dhe janë prezantuar 5 autobusë.

Vlerësimi i Komisionit selektues:

Pas shqyrtimit të ofertave të ofruara nga firma konkurruese, Komisioni selektues ka kërkuar të njoftohen të gjithë prindërit e fëmijëve pjesëmarrës në ekskursion lidhur me ofertat, ku me ç`rast të njëjtit janë ftuar nga mësimdhënësit kujdestarë të klasave dhe takimi është mbajtur në secilën klasë veç e veç. Nga prindërit është kërkuar Pëlqimi për përzgjedhjen e kompanisë për organizimin e ekskursionit, ku komisioni selektues me dt.12.04.2024 (e Premte) ju janë prezantuar Pëlqimet e Prindërve të Nxënësve të Klasave të 12-ta si dhe Pëlqimit nga ana e Këshillit të Arsimitarëve të Klasave të 12-ta (11 mësimdhënës, drejtoresha dhe zëvendësdrejtoresha e shkollës, pra gjithsej 13 veta).

Komisioni selektues jep Vendim që nga ofertat e dorëzuara nga ofertuesit (agjensitë turistike) për Shkollën "Kadri Kusari" në Gjakovë të përzgjedhet firma SH.P.K. "Meti Tours" me çmim prej 120.00€

Pas shqyrtimit Komisioni vendosi ta zgjedhë agjencinë turistike **SH.P.K. "Meti Tours" me drejtor Hysen Musa –Skivjan –Gjakovë.**



Arsyetim

Pas shqyrtimit të ofertave të ofruara nga firma konkurruese, Pëlqimit nga ana e Këshillit të Arsimitarëve të Klasëve të 12-ta (11 arsimtarë ,drejtoresha ,zëvendësdrejtoresha pra gjithsej 13 veta), Pëlqimit të Këshillit të Prindërve për secilën klasë veç e veç (për 11 klasë), listave për aprovimin e ekskursionit të nënshkruara nga prindërit e të gjithë nxënësve që do të marrin pjesë në ekskursion, Komisioni selektues jep Vendim që nga ofertat e dorëzuara nga ofertuesit (agjensitë turistike) për Shkollën “Kadri Kusari” në Gjakovë të përzgjedhet firma **SH.P.K. “ Meti Tours” me çmim prej 120.00€**, gjithashtu hoteli i prezantuar nga agjencia turistike ofron siguri të mjaftueshme që të mos ketë hyrje dhe dalje nga persona të pa autorizuar (rrethoja) të paraparë sipas pikës 5 të Kërkesës për ofertë me numër të protokollit 01/379 i dt.02/04/2024 të shkollës “Kadri Kusari” në Gjakovë.

Komisioni selektues:

1.Merita Bokshi
(emri dhe mbiemri)

Kryesuese e Komisionit
(pozita)

dt. 16/04/2024



2.Anton Pnishi
(emri dhe mbiemri)

Anëtar
(pozita)

dt.16/04/2024



3.Flutur Këpuska
(emri dhe mbiemri)

Anëtare
(pozita)

dt.16/04/2024



Këshilla juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afatin prej 7 ditësh, prej ditës së pranimit të së njëjtit. Ankesa i adresohet Komisionit të Ankesave në Komunën e Gjakovës.

Vendimi iu dërgohet:

- Agjencie turistike
- Komisionit të Ankesave
- Shërbimit juridik
- Arkivit